

VENDIM
Nr.1424, datë 10.10.2008

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

a) Në fund të shkronjës “b” të pikës 1 shtohet emërtesa “Qendra e shërbimeve dhe administrimit të mjeteve të transportit, të sistemit të Ministrisë së Brendshme.”.

b) Lidhja nr.1/5, e përmendur në pikën 2/5, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Në pikën 14/1 pas emërimit “... Shërbimit Informativ Ushtarak” shtohen “... dhe qendrës së shërbimeve dhe administrimit të mjeteve të transportit, të sistemit të Ministrisë së Brendshme..”.

2. Punonjësit mbështetës ekzistues të qendrës së shërbimeve dhe administrimit të mjeteve të transportit, të sistemit të Ministrisë së Brendshme, të cilët, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë përfituar një pagë më të lartë se ajo e parashikuar sipas vendimit nr.1231, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, do të ruajnë nivelin e mëparshëm të pagës, deri në çastin e rishikimit të vendimit nr.1231, datë 2.7.2008, sipas përcaktimeve të tij.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2008, të përballohen nga fondet e miratuara për sistemin e Ministrisë së Brendshme dhe sistemin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare:

- për ndryshimin e parashikuar për Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, nga çasti i emërimit të nëpunësit;

- për qendrën e shërbimeve dhe administrimit të mjeteve të transportit, të sistemit të Ministrisë së Brendshme, nga data 1 gusht 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1/5

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË POZICIONET “SPECIALIST”
DERI NË “TITULLAR I INSTITUCIONIT” NË INSTITUTIN E SIGURISË USHQIMORE DHE
VETERINARISË

PAGA MUJORE					
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHITESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-a	11.000	2%		103.500
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	11.000	2%		86.500

Përgjegjës departamenti	III-a	11.000	2%		68.500
Përgjegjës sektori, në sektorët e përmbajtjes Drejtor në drejtorinë mbështetëse	III-a/1	11.000	2%		58.300
Përgjegjës sektori, në sektorët mbështetës Specialist me grada e tituj shkencorë, në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes	III-b	11.000	2%		51.500
Specialist pa grada e tituj shkencorë në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes	IV-a	11.000	2%		39.000
Specialist zbatues pa grada e tituj shkencorë në departamentet dhe sektorët e përmbajtjes Specialist në sektorët mbështetës	IV-b	11.000	2%		29.000